



Datë: 26.09.2025
Numër Protokolli: 6357/2025

A.nr.777/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj, si procesmbajtëse, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.777/2025, të datës 30.04.2025, të parashtruar nga ankuesja, B.Sh-R, kundër organit të punësimit: Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.777/2025, të datës 30.04.2025, të parashtruar nga ankuesja, B.Sh-R.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil, B.Sh-R (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), më datë 30.04.2025, përmes postës elektronike (ankesa.kpmshck@rks-gov.net), ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00016564, për Grupin Ligjor, gjegjësisht, për pozitën e punës *Zyrtar i Lartë Ligjor*, të shpallur nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturorë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 14.05.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, ndërsa, kjo e fundit, më datë 20.05.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë përmbushur kushtet për përfundim të procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.777/2025, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, më datë 30.01.2025, ka shpallë konkursin publik me numër reference RN00016564, për Grupin Ligjor, respektivisht për pozitën e punës *Zyrtar i Lartë Ligjor*, me klasë të pozitës Profesional 1, një (1) vend i lirë pune, i hapur për aplikim nga data 31.01.2025 deri më 01.03.2025.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar edhe ankuesja e cila ka kaluar fazën e verifikimit paraprak duke i plotësuar kushtet e konkursit, dhe se e njëjta i është nënshtruar vlerësimit profesional, gjegjësisht në testin me shkrim është vlerësuar më 54.6 pikë, ndërsa në intervistën më gojë më 22.6 pikë, gjithsej 77.2 pikë, mirëpo, sipas renditjes përfundimtare të rezultateve të vlerësimit ankuesja është renditur si kandidatja e dytë më më shumë pikë, rrjedhimisht, si kandidate me më shumë pikë rrjedhë të jetë D.B me gjithsej 90.4 pikë (64.4 pikë në testin me shkrim dhe 26 pikë në intervistën më gojë), ashtu që, edhe e njëjta është shpallura edhe kandidate fituese sipas Njoftimit më numër protokoli Nr.20/25, të datës 01.04.2025 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturor.

Pas publikimit të Njoftimit me numër protokoli Nr.20/25, të datës 01.04.2025, ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar ligjshmërinë e kësaj procedure. Shton se nuk është bërë vlerësim i duhur i testit me shkrim, nga ana e Komisionit të Vlerësimit, më theks të veçantë i eses, gjithashtu, pretendon se duhet të bëhet vlerësim i detajuar i përvojës së punës së kandidates fitues në këtë proces rekrutimi. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anuloh procesin e rekrutimit në tërësi.

Duke qenë së kundër procedurës me numër reference RN00016564, kishte parashtruar ankesë edhe M.P, si kandidatë në procedurën e njëjtë, Këshilli me Vendimin me numër A.nr.686/2025, të datës 30.05.2025, ka anuluar Njoftimin e Nr.20/25, të datës 01.04.2025 lidhur me shpalljen e kandidatit fitues si dhe çdo veprim tjetër që ka rrjedhë nga kjo procedurë e rekrutimit. Andaj, referuar këtyre rrethana ligjore dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.1193/2025, të datës 23.06.2025, ka të bëjë me procedurën e pranimit për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.1242/2025, të datës 25.08.2025, rrjedhimisht, ka anuluar në tërësi procedurën e kontestuar, Kolegji në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot”*, vlerëson se objekti i ankesës A.nr.1193/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.777/2025

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankueses, B.Sh-R;*
- *Njesisë se Burimeve Njerëzore në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore ; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*